



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës së Kuvendit

Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 25. 11. 2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës së Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni-Kaloshi, Kolë Berisha, Dzezair Murati, Ramadan Gashi, Ahmet Isufi, Suzan Novobrdaliu dhe Radmila Vujovic.

Në mbledhje munguan Fatmire Berisha dhe Besa Gaxherri.

Të pranishëm nga zyra e komisioneve të Kuvendit ishin: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi .

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni-Kaloshi - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Rekomandimet nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kuvendin e Kosovës,**
- 2. Të ndryshme .**

1. Rekomandimet nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kuvendin e Kosovës

Hydajet Hyseni tha se kjo mbledhje është vazhdimësi e punës së Komisionit, njëkohësisht falënderoi z. Ahmet Isufi për kontributin që e ka dhënë në kryesimin e Komisionit gjerë më tani. Me riaktivizimin e punës propozoi që Komisioni, të përqendrohet në detyrat që kanë dalë pas Raportit të Progresit, me rekomandimet të cilat i drejtohen Kuvendit, dhe praktikave procedurale të tij. Mendon se ato vërejtje do të mund të inkorporohen, në draftin e Rregullores dhe Projektregullorja e Punës së Kuvendit të përfundohet dhe të kërkohet miratimi i saj.

Ahmet Isufi i falënderoi anëtarët e Komisionit për bashkëpunimin e deri tanishëm si dhe z. Hydajet Hysenit i dëshiroi punë të mbarë në kryesimin e Komisionit. Lidhur me Projektregulloren e Punës së Kuvendit tha se pa fajin e anëtarëve të Komisionit, është zvarritur miratimin i saj.

Gilenn Bradburg nga NDI në mes tjerash tha se, jemi duke pritur që të miratohet Projektregullorja e Punës së Kuvendit, rregulla të cilat sigurojnë një funksionim më të mirë të punës së Kuvendit. I sugjeroi anëtarët e Komisionit që të miratojnë Projektregulloren e Punës sa më parë, duke pasur parasysh se ajo ka filluar së punuari qysh para dy vitesh. Ofroi gatishmërinë e NDI për ndihmë Komisionit që ky draft të miratohet sa më parë. Miratimi i Projektregullores me vërejtjet nga Raporti i Progresit të KE do të jetë i vlerësuar pozitivisht në Raportin e ardhshëm .

Hydajet Hyseni lidhur me Projektregulloren tha se, është me të vërtetë një vakum që zgjat disa muaj nga se është proceduar dhe janë shkelur procedurat. Me formimin e komisioneve të reja, duhet shqyrtuar që të mos kemi kolizion në mes të fushëveprimit të tyre, po ashtu deri në mbledhjen e ardhshme të punojmë për harmonizimin e Projektregullores me ato rekomandime që i konsiderojmë të nevojshme sipas Raportit të Progresit, pasi e kemi rastin që të bëjmë një punë shkurtër dhe ta procedojmë për miratim sa më parë. Si rekomandime kryesore nga Raporti i Progresit janë sugjeruar mbikëqyrja parlamentare ndaj ekzekutivit dhe precizimi në Rregullore i obligimeve të ekzekutivit në raport me Kuvendin, si në komisione parlamentare ashtu edhe në seanca plenare. Po ashtu është kërkuar që Komisioni për të Drejtat e Njeriut t'a shqyrtoj çdo P/ligj nga aspekti i tij dhe të harmonizohet planit ligjvënës në mes të Kuvendit dhe Qeverisë, propozime këto të cilat mund të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme.

Ahmet Isufi tha se ne duhet të kërkojmë nga Kryesia që ta procedoj Projektregulloren për miratim në Kuvend pasi është bërë leximi i parë i saj. Çështja e inkuorimit të vërejtjeve tani do të shkaktonte një vonesë edhe më madhe, prandaj duhet të kërkojmë vetëm miratimin e Projektregullores në Kuvend.

Hydajet Hyseni mendon se është një pozitë e papërshtatshme procedurale, Rregullorja është shtyrë nga shqyrtimi në Kuvend dhe tani Komisioni ka hapësirë të bëj plotësime eventuale, në një afat shumë të shkurtër.

Suzan Novobrdaliu kritikoi Kryesinë për vonesën e shkaktuar në miratimin e Rregullores, dhe kërkoi që të jepen shpjegime pse janë bërë vonesa në miratim, për të cilat edhe Komisioni mund të konsiderohet i pasuksesshëm. Lidhur me vërejtjet nga Raporti i Progresit, propozoi që ato t'i përcillen Komisionit përmes GP-re. E falënderoi NDI për ndihmën e ofruar Komisionit gjatë hartimit të Projektregullores.

Hydajet Hyseni lidhur me Projektregulloren e Punës tha se, Kuvendi ka vendosur t'a shtyjë miratimin pasi që kanë munguar shumica e numrit të nevojshëm të deputetëve për miratimin e Rregullores. Propozoi që mbledhja e radhës të mbahet pas një jave me shqyrtimin e propozimeve për amendamente, të cilat do të mund të inkuoroheshin.

2. Të ndryshme

Hydajet Hyseni tha se anëtarët e Komisionit është mirë të japin propozime rreth planin të punës për këtë pjesë të vitit. Propozoi që të punohet për procedimin e Projektregullores, çështjes së mandateve dhe imuniteteve të deputetëve, përgatitjet për anekset e Projektregullores, terminologjitë dhe çështjet e tjera.

Ahmet Isufi propozoi që të procedohet Projektregullorja e Punës në procedurë të rregullt për miratim në Kuvend. Shtroi çështjen e ndërrimit të stafit duke vu në theks angazhimet e tyre, pasi që stafi i mëparshëm ka qenë shumë i ngarkuar edhe me komisione të tjera dhe nuk ka mundur ta përcjellë sa duhet punën e Komisionit. Propozoi të kërkohej staf profesional dhe krijimi i kushteve për punë të mirëfilltë të kryetarit të Komisionit .

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E hartoi:

Njësia për Mbështetje të Komisionit

Kryetari i Komisionit
Hydajet Hyseni -Kaloshi
